



PROCESVERBALI

Mbledhja e Komitetit për Komunitete e Kuvendit Komunal të Rahovecit, e mbajtur më datë: **31.03.2026**, me fillim në orën **10:00**. Këtë mbledhje e kryesoi fillimisht anëtari më i vjetër i Komitetit për Komunitete, **z. Ramë Berisha**. Ky është takimi i **parë** për vitin 2026. Për takimin e sotëm i kemi këto pika të rendit të ditës:

REND DITE

- 1. Zgjedhja e kryesuesit të Komitetit për Komunitete;**
- 2. Të ndryshme.**

Ramë Berisha: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit! Në rolin e kryesuesit e lexova rendin e ditës dhe tani e vendosim në votim. Kush është “për”?... Miratohet rendi i ditës për mbledhjen e sotme.

1. Zgjedhja e kryesuesit të Komitetit për Komunitete:

Skender Hamza: Atëherë, pika e parë e rendit të ditës është zgjedhja e kryesuesit, në këtë pikë duhet ta zgjedhim edhe zëvendëskryesuesin. Sipas udhëzimit administrative, kryesuesi zgjidhet me shumicë votash nga anëtarët e komitetit.

Feriz Thaqi: Përshëndetje për të gjithë! Si kryesues i komitetit e propozoj Genta Morinën.

Edonita Berisha: Si zëvendëskryesues, meqë ka qenë edhe herën e kaluar, e propozoj përsëri Dushanin.

Ramë Berisha: Atëherë, kush është për Gentën si kryesuese dhe Dushanin si zëvendëskryesues?

Unanimisht aprovohen këto propozime.

Skender Hamza: E ftojme kryesuesin, si dhe zëvendëskryesuesin të ulen në vendet e tyre këtu lart.

Kryesuesja: Përshëndetje për të gjithë anëtarët e komitetit! Ju premtoj që do të punoj me përkushtim. Si prioriteti gjithmonë do t'i kem interesat e komuniteteve dhe fuqizimin institucional të tyre. Çdo herë do të bashkëpunojmë për rezultate konkrete dhe të vazhdueshme. Faleminderit dhe na priftë e mbara!

2. Të ndryshme:


Lendrit Qeli: Ju uroj të gjithëve për mandatin e ri. E mora fjalën që t'ju them se do të bashkëpunojmë për të gjitha çështjet e komitetit për komunitete. Ju dëshiroj suksese!

Ramë Berisha: Ju uroj sukses në vazhdimësi, gjithmonë në të mirën e përgjithshme!

Kryesuesja: Ju falënderoj! Nëse nuk ka dikush tjetër diçka për të shtuar, po e mbyllim mbledhjen e parë të komitetit. Shihemi në mbledhjen e radhës.

Mbledhja përfundoi: 10:15

Procesmbajtësi


Albion Krasniqi


Kryesuesja e mbledhjes

Genta Morina